

BEQIR META

**PROBLEMI I MINORITETEVE SHQIPTARE DHE GREKE
NË ORGANIZMAT NDËRKOMBËTARE
NË VITET 1925-1929**

Fuqitë e Mëdha evropiane të kohës dhe organizmat ndërkombëtare që merreshin me minoritetet i trajtuan në mënyrë disproporcionale çështjet e minoriteteve të huaja në Shqipëri dhe ato të minoriteteve shqiptare në Ballkan. Në shumë raste nuk ishte i njëjti interesim, nuk ndiqej e njëjta masë dhe të njëjtat parime në gjykimin e çështjeve analoge dhe, çka është më e rëndësishme, nuk merreshin masa proporcionale dhe të njëjta për mbrojtjen e tyre. Si për çdo aspekt të politikës së Fuqive të Mëdha në këtë kohë edhe çështja e minoriteteve iu nënshtrua interesave të tyre politike në rajonin e Ballkanit.

Një shembull konkret ishte qëndrimi i Ambasadës Britanike në Athinë, e cila u ngarkua nga qeveria e saj të bënte hetime lidhur me dëbimin e shqiptarëve nga qeveria greke. I Ngarkuari me Punë i Britanisë së Madhe në Athinë, Atchley u mjaftua me një bisedë me deputetin grek nga provinca e Çamërisë, doktor Bebis, të cilin ai e konsideronte një person të besueshëm dhe në marrëdhënie të mira me myslimanët e Çamërisë.¹ Është e kuptueshme se Bebis mbronte pozitën dhe interesat e qeverisë greke, sa do që u përpoq të dukej se po jepte një gjykim dhe informacion të pavarur. Ai i tha përfaqësuesit britanik se, pretendimet për persekutimin e myslimanëve të Çamërisë ishin pjesërisht të vërteta dhe pjesërisht ekzagjerime ose zmadhime të fakteve të parëndësishme dhe të izoluara. Sipas tij, myslimanët fatkeq të Çamërisë kishin qenë një mollë sherri midis turqve, shqiptarëve dhe grekëve. Të parët ishin të interesuar t'i nxisnin ata që të shkonin në Turqi, shqiptarët ishin të interesuar t'i bindnin ata që të qëndronin në Epir, me qëllim që t'i përdornin për të mbështetur pretendimet e tyre dhe grekët vetëm se ishin shumë të kënaqur që ata të largoheshin nga Greqia. Bebis, pohonte se gjatë intervaleve të konsiderueshme midis vizitave të Komisionit Miks,

¹ Public Record Office; Foreign Office (FO) 286/948, Sër Milne Cheetham nga Athina për Austen Chamberlain, Athinë, 19 janar 1926.

myslimanët kishin pasur shumë kohë për të ndryshuar mendimin e tyre, më se një herë, se cila zgjidhje ishte më tërheqëse për ta. Sipas tij, e vetmja mënyrë që çështja e fatit të myslimanëve të Epirit të mos zgjatej deri në pafundësi, ishte të mbarohej sa më shpejt, me të gjitha mjetet e mundshme, puna e Komisionit, qoftë edhe duke rrezikuar që të mos kënaqte një përqindje të konsiderueshme të popullsisë lidhur me destinacionin e saj.

Doktor Bebis e kishte siguruar Atchley se “përrallat” mbi shtypjen e myslimanëve shqiptarë në Epir prej autoriteteve greke, me qëllim që t’i detyronin ata që të emigronin, ishin të rreme. Ai kishte deklaruar se asnjë shqiptar nuk ishte nxjerrë nga shtëpia për të vendosur refugjatët grekë. Midis familjeve që kohët e fundit ishin dëbuar në Janinë, në bazë të ligjit të brigandazhit, kishte pasur edhe disa familje shqiptare nga Çamëria. Ai pretendonte se kishte ndërhyrë që ata të mos dëboheshin dhe ia kishte arritur që shumë prej tyre t’i kthente në shtëpitë e veta. Ai deklaroi se, 75% e myslimanëve të Çamërisë dëshironin të shkonin në Turqi sepse ata, si të gjithë myslimanët, nuk donin të ishin nën një regjim jo mysliman i cili, jo vetëm që i pengonte që të bëheshin një elitë sunduese, por i bënte të sunduar. Gjithashtu ata nuk i donin shqiptarët e Shqipërisë, pasi këta ishin modernistë në çështjet fetare. Bebis u përpoq ta bindë diplomatin britanik se nuk kishte një shtypje të përgjithshme të myslimanëve të Çamërisë. Myslimanët kundërshtonin prezencën e refugjatëve, të cilët ata i konsideronin si ndërhyrës (furacakë) dhe, sigurisht, ishte e mundur që këto grindje të izoluara kishin ndodhur midis myslimanëve dhe refugjatëve, disa prej të cilëve ishin vendosur nëpër xhamia. Sipas tij, refugjatët kishin vuajtur shumë në Çamëri. Në një kamp me çadra, me më shumë se 75 familje, rreth 40 persona kishin vdekur brenda dy muajve, shumica e tyre ishin gra dhe fëmijë. Kohët e fundit në Epir, kishin vepruar bandat e shqiptarëve brigandë. Këto banda përbëheshin pjesërisht nga banorë të Çamërisë dhe pjesërisht nga banorë të Shqipërisë. Ndërsa lidhur me deklaratën e përfaqësuesit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, Mehdi Frashëri, se bandat greke po vepronin në interes të qeverisë greke në Çamëri, doktor Bebis theksoi se, Colovos (i cili ishte përmendur nga M. Frashëri) kishte qenë me bandën e tij në Maqedoni dhe jo në Epir. Kuptohet se, kjo ishte një paraqitje tendencioze e realitetit në Çamëri megjithëse Bebis ishte përpjekur të tregojë disi objektiv kur kishte pohuar edhe disa dëshira të qeverisë greke për dëbimin e shqiptarëve.

Një shembull tjetër ishte edhe qëndrimi i qeverisë britanike dhe i Këshillit të LK lidhur me kërkesën e qeverisë shqiptare për t'i dhënë një hua për sistemimin e refugjatëve shqiptarë në Shqipëri. Duke mos dashur të futej në rrugën e dëbimit reciprok të minoritetit grek në Shqipëri, qeveria shqiptare i paraqiti Këshillit të LK një projekt të hartuar nga koloneli Stërlling për sistemimin e refugjatëve që po largoheshin nga Turqia për në Shqipëri. Ai kishte llogaritur se numri i tyre mund të arrinte në rreth 35.000 vetë dhe ata kishin shkuar atje qoftë nga Greqia ashtu dhe nga Jugosllavia. Kështu që, qeveria shqiptare kishte kërkuar një hua prej 3 milion franga ari e cila do të garantohej nga pasuria shtetërore që llogaritej në një milion paund. Qeveria shqiptare kërkoi edhe mbështetjen e qeverisë britanike për realizimin e kësaj huaje. Ajo, gjithashtu ishte e gatshme të pranonte, që kjo hua të administrohej nga një komision i LK. Por zyrtarët britanikë nuk pranuan të angazhoheshin.²

Po kështu një qëndrim aspak i paanshëm dhe i balancuar ishte ai i Mandatorëve të Komisionit Miks ndaj memorandumit të përfaqësuesit të qeverisë shqiptare të 4 dhjetorit 1925, të cilin e konsideronin si të bazuar në një informacion të pasaktë dhe tërësisht imagjinar.³

Më 1 mars 1926, përfaqësuesi i qeverisë shqiptare M. Frashëri i parashtroi edhe një herë Sekretarit të LK shqetësimin se, qeveria greke po dëbonte 800 banorët shqiptarë të fshatrave Kardhiq dhe Dragumi. Megjithëse gjenerali De Lara kishte deklaruar në mbledhjen e Këshillit të LK, më 10 dhjetor 1925 se në qoftë se këto dy fshatra do të deklaroheshin se ishin shqiptare ata do të përjashtoheshin nga shkëmbimi i detyrueshëm, Komisioni Miks e hodhi poshtë kërkesën e qeverisë shqiptare, duke deklaruar me arrogancë se mandatorët e tij ishin të vetmit autoritete kompetente që mund të përcaktonin origjinën e banorëve të Dragumit dhe të Gardhiqit.⁴ Me gjithë këtë, mesa duket, presioni i qeverisë shqiptare dha rezultat dhe, disa dit më vonë, mandatorët informuan Sekretarin e Përgjithshëm të LK se ata “ishin në gjendje të deklaroheshin, në bazë të hetimeve që kishin kryer në terren dhe të raporteve e informacionit që ata kishin mbledhur, se e konsideronin popullsinë

² Po aty, Shënime të Howard Smith (Central Department) në Forin Ofis, 19 janar 1926.

³ FO 286/948, Memorandum i anëtarëve neutralë të Komisionit Miks për Eric Drummond, 23 janar 1926.

⁴ Po aty, Letër e M. Frashërit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të LK, 1 mars 1926, dhe telegram i Mandatorëve për Sekretarin e Përgjithshëm, 4 mars 1926.

muslimane të Çamërisë në përgjithësi dhe të fshatrave Gardhiq e Dragumi në veçanti, si një popullsi me origjinë shqiptare dhe, rrjedhimisht, ajo ishte e pa shkëmbyeshme, me përjashtim të rasteve të pakta të izoluar për të cilat origjina shqiptare ishte e diskutueshme.”⁵

Duke e ndërë rrezikun që vinte prej ndryshimit të qëndrimit të mandatorëve të Komisionit Miks dhe duke dashur të mbronte dhe konservonte rezultatet e arritura në spastrimin e pjesëshëm etnik të minoritetit shqiptar në Greqi, qeveria greke nxitoi të deklaronte në Këshillin e LK se ajo dëshironte të suprimonte Nënkomisionin e Epirit, duke pohuar se tashmë shkëmbimi kishte përfunduar. Qeveria greke vendosi gjithashtu të mos kërkonte më largimin e 800 personave që kishin mbetur pezull. Popullsia e Çamërisë që nuk ishte shkëmbyer do të gëzonte të njëjtin trajtim ligjor dhe faktik si dhe qytetarët e tjerë grekë. Të gjitha masat e veçanta që qeveria greke kishte aplikuar ndaj kësaj popullsie, pasi e kishte konsideruar atë si të shkëmbyeshme, do të anuloheshin. Këshilli i LK e mirëpriti këtë deklaratë dhe e konsideroi punën e mandatorëve të Komisionit Miks si të përfunduar.⁶ Megjithëkëtë Komisioni Miks edhe në korrik të vitit 1926 ende nuk e kishte konsideruar të suprimuar Nënkomisionin e Epirit.⁷

Pasi arriti një sukses të konsiderueshëm në spastrimin etnik të shqiptarëve në Greqi, qeveria greke filloi presionin për fuqizimin e pozitave ekonomike e sociale të minoritetit grekofon në Shqipëri. Ambasadori grek në Shqipëri i paraqiti një memorandum përfaqësuesit britanik Robert Perr, në të cilin thuhej se një pjesë e konsiderueshme e minoritetit grek në provincën e Gjirokastrës ishte vendosur në pronat e bejlerëve qysh në kohën e Ali Pashë Tepelenës, megjithëse në shumicën e rasteve ata ishin vendosur më herët. Ambasadori grek sqaronte se në Perandorinë Otomane pronat konsideroheshin si “mirie”, siç ishte praktikisht statusi i gjithë pronave në Epir. Fshatarët u paguanin një pjesë të prodhimit të tyre bejlerëve, por të drejtat e tyre ishin të garantuara nga ligji dhe dukej se nuk kishte probleme, por fshatarët konsideroheshin si përfitues të fryteve të pronave ku ata ishin vendosur. Ai ankohej se, qysh

⁵ Po aty, Raport i Viskontit Ishii: “Muslimanët me origjinë shqiptare në Greqi”, Gjenevë, 15 mars 1926.

⁶ Po aty.

⁷ Po aty, Mandatorët për Sekretarin e Përgjithshëm, Konstandinopol, 5 maj 1926; Hans Holstad në emër të mandatorëve për Sekretarin e Përgjithshëm, Konstandinopol, 14 korrik 1926.

prej krijimit të shtetit shqiptar, kishte pasur përpjekje të vazhdueshme nga ana e bejlerëve për të fituar të drejtën që të jepnin tokën me qira dhe ta konsideronin veten vetëm si qiradhënës, duke reduktuar kështu pozitën e fshatarëve vetëm në atë të qiramarrësit të thjeshtë. Ai akuzonte qeverinë shqiptare se në shumë raste i kishte njohur këto të drejta të pronarëve dhe kishte njohur si prona të pronarëve të tokës edhe pyjet, kullotat dhe ndërtesat në kufijtë e çifligjeve të tyre, ndërsa më parë këto kishin qenë subjekte të titujve të veçantë të pronësisë. Rrjedhimisht, pozita e fshatarëve ishte keqësuar në mënyrë radikale dhe të gjitha përmirësimet e cilësisë së tokës së punueshme që ishin bërë në vite dhe që ishin konsideruar si pronë familjare e bujqve, ishin bërë pronë e pronarëve, të drejtat autentike të të cilëve mbi këto çifligje kishin qenë, në rastin më të mirë, disi të dyshimta. Përfaqësuesi grek ankohej se kohët e fundit shumë pronarë tokash kishin përfituar nga gjykatat urdhra dëbimi dhe po zëvendësonin familjet grekofone me myslimanë, veçanërisht me refugjatë nga Kosova dhe Çamëria. Në fakt kjo ishte një paraqitje krejtësisht e shtrembër dhe tendencioze e realitetit. Ai shtoi se kjo çështje ishte bërë subjekt i diskutimeve midis qeverive greke dhe shqiptare dhe qeveria greke mund ta shtronte atë në Komisionin e Minoriteteve të LK.⁸

Edhe pas vitit 1926 qeveria greke nuk i mbajti aspak angazhimet e marra para LK por vazhdoi në heshtje dhe me këmbëngulje procesin e presionit për dëbimin e shqiptarëve të mbetur në Greqi. Kështu në shtator të vitit 1927 Sekretari i Përgjithshëm i LK mori një peticion të nënshkruar nga Ali Dino, në emër të fshatarëve të Gardhiqit dhe Dragumit, në të cilin thuhej se autoritetet greke vijonin të mbanin të sekuestruara shtëpitë e tyre dhe tokat në favor të refugjatëve. Sekretari i Përgjithshëm ia parashtrroi këtë ankesë qeverisë greke⁹ e cila u përpoq që ta mohonte dhe justifikonte veprimin e saj. Këshilli i LK, nga ana e tij nuk mori ndonjë masë për ta verifikuar dhe zgjidhur problemin dhe, kështu, qeveria shqiptare u detyrua t'i drejtohej Sekretarit të Përgjithshëm të LK, me një letër të veçantë në mars të vitit 1928.¹⁰

⁸ FO 286/968, R. Parr nga Durrësi për Sër Austen Chamberlain, 20 shtator 1926, bashkë me memorandumun e përfaqësuesit grek.

⁹ FO 371/12924, Peticion i Ali Dinos, 28 gusht 1927, dhe nota e Sekretarit të Përgjithshëm për anëtarët e Këshillit të LK, 29 dhjetor 1927.

¹⁰ Po aty, Letër e ministrit të Jashtëm të Shqipërisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Tiranë, 1 mars 1928.

Qeveria shqiptare ankohej se Greqia nuk po respektonte detyrimet që rridhnin nga Traktatet e LK për minoritetet si dhe angazhimet që ajo kishte marrë më se një herë para Këshillit të LK. Pozita e minoritetit shqiptar në Greqi vijonte të ishte e rrezikuar. Atij, jo vetëm që nuk i ishin garantuar të drejtat politike dhe kulturore, por ishte në rrezik vetë ekzistenca e tij. Me qëllim që të detyronte këtë minoritet të largohej nga vatra e tij, Çamëria, po bëheshin presione konstante ndaj tij. Metoda më e përhapur ishte shpronësimi i këtyre njerëzve fatkeq nga pronat e tyre, duke i privuar ata nga mjeti themelor i mbijetesës. Si rezultat i këtij presioni konstant shumë familje çame ishin shpërngulur në Shqipëri, duke krijuar vështirësi për qeverinë shqiptare dhe duke zemëruar opinionin shqiptar.

Peticione të vazhdueshme i ishin dërguar qeverisë greke për të ndryshuar këtë qëndrim por ata kishin qenë pa rezultat. Qeveria greke nuk kishte marrë ende masa për të rivendosur në shtëpitë e tyre ata çamë që kishin qenë të detyruar t'u lëshonin shtëpitë e tyre refugjatëve grekë ose që ajo t'i jepte fund masave të jashtëzakonshme që kishte marrë më parë siç ishte rasti i fshatrave Gardhiq dhe Dragum. Ishte surprizë fakti që nuk kishte asnjë shkollë shqipe për minoritetin e madh shqiptar në Çamëri ndërsa minoriteti grek në Shqipëri gëzonte plotësisht të gjitha të drejtat civile, politike dhe kulturore. Dy anëtarë të parlamentit shqiptar i përkisnin këtij minoriteti, administrata shqiptare kishte një numër relativisht të madh zyrtarësh të lartë që i përkisnin minoritetit grek dhe në Shqipëri funksiononin rreth 60-70 shkolla greke.

Në notën shqiptare përmendeshin edhe dy probleme të tjera në të cilat dukej qartë se qeveria greke kishte dëmtuar rëndë interesat shqiptare. *Së pari*, ishte çështja e konventave. Të dy shtetet kishin nënshkruar një sërë konventash si një traktat tregtar, një konventë ekstradimi, një konventë konsullore dhe një konventë mbi kushtet e qëndrimit dhe biznesit dhe një traktat të shtetësisë. Sapo këto marrëveshje ishin nënshkruar, parlamenti shqiptar i kishte ratifikuar, ndërsa pala greke e kishte zgjatur shumë procesin e ratifikimit. Por edhe pas ratifikimit, qeveria greke, për arsye të pajustificueshme, kishte refuzuar që të shkëmbente instrumentet e ratifikimit.

Së dyti, ishte çështja e pronave tokësore të shqiptarëve në Greqi. Në Greqi ishin zbatuar një sërë ligjesh shpronësuese dhe shqiptarët ishin shpronësuar thuajse plotësisht. Kështu, në bazë të rregullave më elementare të drejtësisë, duhej që qeveria greke t'i shpërblente pronarët

për këtë shpronësim. Por pronarët shqiptarë nuk kishin marrë asgjë për pronat e tyre të shpronësuara. Ky qëndrim i qeverisë greke kishte shkatërruar qindra familje shqiptare. Qytetarët shqiptar kishin shkuar shpesh në Greqi dhe ishin detyruar të qëndronin atje për periudha të gjata, pa zgjidhur asnjë problem. Qeveria shqiptare mendonte se këto metoda ishin përdorur për të shkurajuar pronarët shqiptarë që ata të mos vijonin kërkesat e tyre për kompensimin e pronave të veta. Ajo i kërkonte palës greke që pronarët shqiptarë të kompensoheshin sipas metodës dhe procedurës që kishte aplikuar qeveria greke në konventat e nënshkuara, për këtë çështje, me qeveritë britanike dhe italiane. Me qëllim që t'i vinte në ndihmë qeverisë greke dhe për të dhënë një provë të qëndrimit të saj pajtues dhe të moderuar, qeveria shqiptare ishte e përgatitur të pranonte një reduktim të konsiderueshëm në koeficientin e shpërblimit që ishte aplikuar në konventat e nënshkuara nga qeveria greke me qeveritë britanike dhe italiane. Qeveria shqiptare shpresonte se kjo kërkesë e moderuar do të shqyrtohej në frymën e miqësisë dhe drejtësisë edhe për arsye se, sipas të dhënave që ajo dispononte, sipërfaqja e tokës që tashmë ishte shpronësuar ose ishte parashikuar për t'u shpronësuar nuk i kalonte 500.000 stremët.

Qeveria shqiptare deklaronte se dëshironte të mbante marrëdhënie të mira fqinjësie me Greqinë dhe të shmangte ndonjë ngjarje që mund të krijonte një krizë të këtyre marrëdhënieve por, në të njëjtën kohë, ajo kishte për detyrë që të mbronte interesat e bashkëkombësve të saj. Prandaj ajo do ta shtronte këtë çështje, në bazë të artikullit të 11 paragrafit 2 të Konventës së LK, para Këshillit në sesionin e qershorit.

Më parë dhe pikërisht në shkurt të vitit 1928 qeveria shqiptare, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në Athinë, i kishte paraqitur një memorandum konfidencial qeverisë greke¹¹ në të cilin theksonte se fshati Gardhiq kishte pasur 400 shtëpi dhe tani kishte vetëm 10-15 shtëpi, Dragumi kishte pasur 80 familje dhe tani numri i tyre ishte reduktuar në 30, Margariti nga 600 familje ishte reduktuar në 30, Karbunara me 300 familje kishte vetëm 40. Të njëjtin fat kishin pasur dhe fshatrat e tjerë si Nihori, Minina, Piadhuli, etj. Në memorandum thuhej se pa u ndryshuar ky qëndrim ndaj çamëve, qeveria shqiptare kishte shumë arsye të ishte e frikësuar se ky minoritet do të detyrohej të largohej nga vatrat e tij

¹¹ FO 371/12924, Memorandum konfidencial i qeverisë shqiptare për qeverinë greke, 3 shkurt 1928.

shekullore dhe të vendosej si refugjat në Shqipëri, duke e vënë kështu qeverinë shqiptare në një pozitë shumë të vështirë. Legata shqiptare theksonte se nga peticionet e çamëve mund të arrihej në përfundimin se ndaj tyre ishte bërë presion për ti detyruar të emigronin; e drejta e pronës së minoritetit shqiptar në Çamëri ishte shkelur rëndë dhe, megjithëse çamët ishin përjashtuar nga shkëmbimi i detyrueshëm, toka e tyre po mbahej ende e sekuestruar. Një pjesë e madhe e saj u ishte dhënë refugjatëve grekë, duke lënë kështu shumë persona pa shtëpi dhe mjete jetese megjithëse Greqia kishte pranuar më parë në Këshillin e LK që refugjatët grekë nga Azia e Vogël do t'i lironin këto shtëpi. Minoriteti shqiptar nuk kishte të drejtën të zgjidhte dhe të zgjidhej dhe nuk kishte asnjë shqiptar në këshillat komunale dhe bashkiake. Anëtarët e këtyre këshillave ishin emëruar direkt nga guvernatori i përgjithshëm i Janinës. Asnjë person nga ky minoritet nuk kishte ndonjë vend në Parlament. Rekrutët e rinj me origjinë shqiptare ishin angazhuar vetëm në ndërtimin e rrugëve, në vend që të angazhoheshin në batalionet ushtarake. Në Çamëri nuk kishte asnjë shkollë në gjuhën shqipe.

Kërkesa e palës shqiptare për ta diskutuar çështjen e pronave dhe të minoritetit shqiptar në Greqi në Këshillin e LK nuk u prit mirë nga përfaqësuesi i qeverisë italiane. Grandi i shkruante Legatës Italiane në Athinë se, duke pasur parasysh marrëdhëniet tona miqësore me të dy vendet, duhet të nxiten ata që ta diskutojnë çështjen midis tyre. Në qoftë se Këshilli do të merrej me këtë çështje, qeveria italiane mund të gjendej në një pozitë më delikate se sa ajo që ishte ndodhur në çështjen e optanëve hungarezë.¹²

Një qëndrim të njëanshëm dhe tendencioz mbajti në këtë kohë edhe Forin Ofisi. Zyrtari i kësaj ministrie C. Harvey, në një memorandum për Sekretarin e Jashtëm¹³, shkruante se, ndonëse mund të ishte e vërtetë se qeveria greke po sillej keq, duke shtyrë ratifikimin e konventave greko-shqiptare të cilat i kishin propozuar vetë, kjo nuk ishte një çështje për t'i dërguar grekët në Gjenevë. Ai mendonte se shtyrja e ratifikimit padyshim lidhej me klauzolën e kombit më të favorizuar në Konventën Konsullore e cila i detyronte grekët që t'u jepnin një trajtim të njëjtë pronarëve

¹² HW 12/106, Telegram nga Grandi në Romë për legatën italiane në Athinë, 30 maj 1928. Marrë nga botimi i Bejtulla Destanit, *Ethnic Minorities in the Balkan States, 1860-1971*, volume 5: 1927-1938, London 2003, f. 45.

¹³ FO 371/12924, Memorandum i C. Harvey për Sekretarin e Jashtëm, Londër, 17 maj 1928.

shqiptarë si ai që u kishin dhënë atyre britanikë. Ai theksonte se pronarët shqiptarë kishin pësuar ekzaktësisht të njëjtat pasoja si dhe qytetarët grekë dhe të gjithë qytetarët e huaj nga shpronësimi i tokave të tyre të cilat u ishin dhënë refugjatëve grekë dhe ata nuk kishin marrë asnjë qindarkë si kompensim. Në këtë çështje nuk kishte një diskriminim ndaj të huajve të cilët ishin trajtuar në të njëjtën mënyrë si dhe qytetarët grekë. Por përkundrazi, janë të huajt që po pretendojnë të trajtohen më mirë se sa grekët. Marrëveshja për pasuritë greko-turke, e cila qëndron në themel të çështjes, ishte një detyrim i Traktatit të Lozanës, e cila kërkonte kthimin e pronave të pronarëve grekë e turq siç i kishin pasur më parë. Dhe, në se nuk do të kishte mundësi që të ktheheshin tokat, atëherë një marrëveshje ishte nënshkruar midis dy palëve që të dy kategoritë e pronave të vlerësoheshin dhe qeveria që kishte diferencën duhej t'ia paguante qeverisë tjetër.

Qeveria britanike kishte arritur që të përdorte termat e këtij konsensusi me qëllim që të nënshkruante një marrëveshje të kënaqshme për kompensimin e pronarëve britanikë të tokave në Greqi. Marrëveshja kishte qenë më pak e favorshme se sa ajo me turqit, por natyrisht më e favorshme se sa ajo që ishte zbatuar për grekët të cilët nuk kishin marrë asgjë. Në fakt, as pronarët britanikë nuk kishin marrë ende paratë e tyre por shpresoj që në të ardhmen, pas vonesave të zakonshme që vinin nga vlerësimi i pronave, ata do t'i merrnin vlerat e përcaktuara. Qeveria italiane kishte nënshkruar një marrëveshje të ngjashme në të njëjtën kohë, ndërsa qeveria franceze e cila kishte vepruar pas shpinës së britanikëve, duke diskutuar një marrëveshje të veçantë me gjeneralin Kondilis, përpara se të vinte në fuqi qeveria ekumenike, tashmë e poshtëruar, po priste pa limit ratifikimin e kësaj marrëveshje. Harvey shkruante se marrëveshjet britanike dhe italiane kishin qenë rezultat i rrethanave të veçanta të cilat kishin bërë të mundur që ata t'ua shtrëngonin rripat grekëve. Ishte e qartë se grekët nuk kishin qëllim që t'i zbatonin këto marrëveshje në mënyrë universale, megjithatë mendoj se vendet që kishin nënshkruar marrëveshjen e kombit më të favorizuar me Greqinë kishin të drejtë të kërkonin një gjë të tillë. Megjithatë Konventa Tregtare greko-shqiptare e cila përmbante këtë klauzolë, ende nuk ishte ratifikuar nga Greqia dhe nuk kishte dyshim se kjo ishte bërë qëllimisht. Sekretin e impenjimit të qeverisë shqiptare për këtë çështje, sipas Harveyt, ishte fakti që shumë politikanë të rëndësishëm shqiptarë dhe veçanërisht Ministri i Punëve të Jashtme, kishin prona të mëdha në Greqi.

Megjithëkëtë Greqia nuk kishte nënshkruar ndonjë marrëveshje të veçantë për këtë çështje as me Rumaninë, as me Jugosllavinë dhe dukej se nuk kishte ndonjë qëllim që të nënshkruante ndonjë marrëveshje të tillë.

Harvey trajtonte edhe çështjen e minoritetit shqiptar në Greqi dhe e cilësonte ankesën e qeverisë shqiptare një ankesë të zakonshme. Ai theksonte se çamët ishin myslimanë të racës shqiptare dhe numri i përgjithshëm i tyre ishte 15.000. Ndërsa në anën tjetër të kufirit ekzistonte një minoritet grek shumë më i madh dhe qeveria shqiptare ishte akuzuar në mënyrë të njëjtë se nuk kishte hapur shkolla për të dhe se nuk e kishte trajtuar në mënyrë të përshtatshme. “Duhet pranuar, theksonte ai, se qeveria greke nuk kishte hapur shkolla për çamët, megjithëse ata nuk kishin bërë ankesa për mos hapjen e këtyre shkollave. Nga ana tjetër qeveria shqiptare kishte hapur 60-70 shkolla për minoritetin grek, megjithëse më parë aty kishte pasur më tepër se dyfishin dhe qeveria shqiptare e kishte mbyllur pjesën tjetër”¹⁴.

Zyrtari i lartë britanik mendonte se si çamët ashtu dhe minoriteti grek në Shqipëri ishin trajtuar sipas traktatit të zakonshëm për minoritetet. Qeveria greke pretendonte se ata ishin numerikisht shumë inferior që të kërkonin hapjen e shkollave të veçanta dhe në këtë drejtim nuk mund të bëheshin krahasime me minoritetin shumë më të madh grek në Shqipëri. Për më tepër, çamët kishin shkaktuar ngatërresa të përsëritura për administratën, pasi ata, në disa raste, kishin pretenduar se ishin një minoritet shqiptar dhe në disa raste të tjera se ishin një minoritet turk. Duhet kujtuar se myslimanët me origjinë shqiptare ishin përjashtuar në mënyrë të veçantë nga shkëmbimi i detyrueshëm i popullsisë greko-turke dhe, në këtë kontekst, ata këmbëngulën në origjinën e tyre shqiptare. Në raste të tjera ata kishin pretenduar se ishin minoritet turk, në kuptimin e Artikullit 4 të Traktatit të Athinës të vitit 1913 i cili parashikonte se personat që dëshironin të aplikonin për kombësinë turke mund ta merrnin këtë, me kusht që të transferoheshin në Turqi. Për arsye të luftës ata nuk qenë në gjendje që ta realizojnë këtë qëllim, megjithëse disa u shpërngulën për në Turqi por duke parë kushtet aq të pakënaqshme në Anatolia, ata kërkuan lejen e qeverisë greke për t’u kthyer në Greqi dhe kjo leje iu dha. Nuk ka dyshim se ka një persekutim të parëndësishëm të çamëve nga autoritetet greke të cilët dëshirojnë të

¹⁴ Po aty.

spastrojnë të gjithë myslimanët sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim që t'u lirojnë vendin grekëve. Edhe diplomati tjetër britanik, Jordan, mendonte në mënyrë tendencioze se qeveria shqiptare shpresonte që, duke e ngritur këtë problem, ajo do të përgatisë rrugën për një shkëmbim të popullsisë dhe në këtë rast pronat e pasura të minoritetit grek në Shqipërinë e Jugut do të merreshin nga qeveria shqiptare në shkëmbim të pronave të pakta dhe të varfra të çamëve në Greqinë Veriore.”¹⁵ Kjo paraqitje tendencioze dëshmon se diplomatët britanikë nuk e njihnin mirë realitetin në Çamëri dhe historinë e çështjes çame. Ata ishin nën ndikimin e propagandës greke dhe raportet e tyre dërguar Forin Ofisit ishin shumë të rrezikshme për të drejtat dhe ekzistencën e minoritetit shqiptar në Greqi.

Shqipëria edhe në vitet e para të Monarkisë po ndiqte një politikë korrekte e liberale ndaj pakicave, por, paralelisht, ajo vijoi politikat e saj për konsolidimin e institucioneve kombëtare fetare, politike etj. Pikërisht kjo tendencë nuk u mirëprit nga fqinjët, të cilët u përpoqën të mobilizonin disa individë të veçantë, oponentë të regjimit dhe të këtij kursi për ta penguar këtë proces.

Më 28 shkurt 1929 Koço Tasi dhe Foto Dussi i dërguan një peticion Lidhjes së Kombeve, duke u paraqitur si “përfaqësues” të organizatave të krishtera “Lekë Dukagjini” e “Gjin Bue Shpata”, dhe si interpretë të ndjenjave të popullit shqiptar të krishterë (ortodoks e katolik)¹⁶.

Në të vërtetë personat e lartpërmendur nuk përfaqësonin askënd, pavarësisht pretendimeve të tyre, por megjithëkëtë Sekretari i LK, Drummond e mori seriozisht këtë peticion dhe njoftoi qeverinë shqiptare se, në përputhje me rezolutat e datave 27 qershor 1921 dhe 5 shtator 1923 të Këshillit të LK, që kishin të bënin me mbrojtjen e minoriteteve, ky peticion do t'u komunikohet anëtarëve të Këshillit, i cili do të kërkonte sqarime prej qeverisë shqiptare¹⁷.

Memorandumi ishte një provë tjetër e qartë se si, duke përdorur ligjet dhe parashikimet për mbrojtjen e minoriteteve, Greqia përpiqej të pengonte konsolidimin e shtetit shqiptar, prandaj kjo është edhe arsyeja e vetme që po e analizojmë në këtë studim.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti 1929, dos. 588, fl. 8-17, dt. 28 shkurt 1929.

¹⁷ *Po aty*, fl. 7, E. Drummond – ministrit të Jashtëm P. Evangjeli, 21 mars 1929.

K. Tasi dhe F. Dusi ankoheshin se nenet 223 dhe 232 të Kushtetutës Shqiptare dhunonin principin e Deklaratës së vitit 1921 sipas të cilit, dispozitat e saj që mbështeteshin në ligje themelore, nuk mund të dhunoheshin nga një ligj tjetër, rregull, apo akt qeveritar. Ndërsa nenet e lartpërmendura të Kushtetutës shqiptare theksonin se “dispozitat ligjore, që janë në kundërshtim me dispozitat e kushtetutës së tanishme, konsiderohen të pavlefshme.” Për këtë arsye ata pretendonin se të drejtat e minoritarëve kishin humbur karakterin mbrojtës ndërkombëtar dhe ishin bërë një çështje e brendshme e Shqipërisë, “të mbetur në një fshehje të plotë të autoriteteve legjislative mosbesuese”¹⁸.

Ata ankoheshin se qeveria shqiptare kishte adoptuar tërësisht Kodin Civil Francez dhe nuk kishte bërë përrjashtime në legjislacion, lidhur me të drejtën e familjes për “minoritetet e krishtera”.

Ankesa tjetër kishte të bënte me karakterin e sistemit elektoral në Shqipëri. Pohohej se të gjitha ligjet elektorale shqiptare, deri në këtë kohë, kishin qenë në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 2 të Deklaratës, e cila përcaktonte që në Shqipëri do të aplikoheshin “një sistem elektoral që i përmbahej të drejtave të minoriteteve të racës, të fesë e të gjuhës”, e cila kishte si qëllim që të jepeshin “garanci reale dhe jo në dukje” për mbrojtjen e të drejtës së minoriteteve.

Ata pretendonin se të drejtat elektorale të minoritetit “të krishterë” ishin të garantuara vetëm në dukje pasi, sipas sistemit elektoral në fuqi në Shqipëri, të krishterët nuk përbënin një kolegji apo bashkësi elektorale të ndarë. Ata e cilësonin kolegjin elektoral të ndarë si të përshtatshëm në paraqitjen proporcionale të krishterëve dhe ky sistem, sipas tyre, ishte një lloj mënyre për të garantuar të drejtat e tyre. Në të vërtetë sistemi që ata kërkonin çonte në prishjen e karakterit unik dhe të bashkuar të shtetit shqiptar e më tej në ndarjen politike dhe në copëtimin e vendit.

Ata pohonin se, sipas sistemit elektoral në fuqi, Shqipëria ishte e ndarë në provinca, ku banorët e krishterë dhe ata myslimanë të çdo province përbënin një kolegji elektoral të ndarë. Të gjitha provincat e Shqipërisë banoheshin nga një shumicë myslimane, përjashtim bënte vetëm provinca e Gjirokastrës dhe e Shkodrës. Autorët e memorandumit ankoheshin se qeveria shqiptare, me qëllim që të evitonte një mbizotërim elektoral të krishterëve në këto dy provinca, kishte marrë masa legjislative ilegale që të reduktonte shumicën e krishterë. Ajo kishte disa

¹⁸ *Po aty*, fl. 8-17.

vite që kishte bërë një ndarje të re administrative të vendit dhe kështu, zonat e pastra katolike të Nikaj-Merturit dhe Kthellë-Selitës, ishin ndarë administrativisht nga provinca e Shkodrës dhe ishin bërë pjesë e provincave myslimane të Kosovës dhe të Dibrës. Po kështu zonat e pastra ortodokse të Himarës e të Leskovikut ishin ndarë nga provinca e Gjirokastrës dhe i ishin bashkuar provincave të Vlorës e të Korçës dhe, për të siguruar shumicën myslimane të Korçës, asaj i ishte bashkangjitur një pjesë e qarkut të Elbasanit.

Ata pranonin se, sipas sistemit elektoral në fuqi, të krishterët kishin të drejtë të përfaqësoheshin me një numër proporcional deputetësh. Por, sipas tyre, ky proporcion ishte i pavlefshëm sepse “nuk ekzistonte, as si numër as si kualitet pasi, duke parë superioritetin numerik të myslimanëve dhe masat legjislative e administrative të mësipërme, numri i deputetëve të krishterë ishte zgjedhur nga zërat (votuesit) myslimanë”¹⁹.

Qeveria shqiptare akuzohej se, në kundërshtim me nenet 2 dhe 5 të Deklaratës, me anë të masave të ndryshme legjislative dhe vendimeve qeveritare, kishte dhunuar lirinë fetare të krishterëve ortodoksë dhe ju refuzonte atyre të drejtën e ushtrimit lirshëm të riteve fetare të kishës së tyre. Që prej shumë vjetësh, qeveria shqiptare kishte ndërhyrë në punët e brendshme të kishës ortodokse, duke demonstruar më tepër forcë se sa zgjidhje për këtë popullsi. Në vitin 1922, me iniciativë të saj dhe nëpërmjet Kosta Paftalit, në atë kohë Bashkiak i Durrësit, ftoi klerin dhe popullin ortodoks për të zgjedhur përfaqësuesit e vet për në asamblenë fetare të Beratit, me qëllim proklamimin e autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare. Populli dhe kleri nuk e aprovuan këtë masë dhe refuzuan të zgjidhnin përfaqësuesit e vet. Me urdhër të qeverisë, kryetarët e bashkive me shumicë myslimane zgjodhën përfaqësuesit ortodoksë për në Asamblenë e Beratit, përfaqësues me një moral të dyshimtë që nuk gëzonin asnjë respekt tek elementi ortodoks, duke qenë gjithë kohën instrumente të myslimanëve. Përfaqësuesit e zgjedhur u mblodhën në Berat dhe hoqën në unanimitet, në mënyrë të parregullt Statusin legal të Kishës Ortodokse dhe krijuan statusin arbitrar të tanishëm. As Patriarkati Ekumenik, koka e ortodoksisë, as populli shqiptar ortodoks nuk e njohën këtë gjendje të re të imponuar dhe problemi fetar ka mbetur pezull.

Qeveria shqiptare, akuzohej se me qëllim që të shkrinte elementin ortodoks e për të dobësuar popullsinë ortodokse, nëpërmjet një përçarje

¹⁹ *Po aty.*

në gjirin e vet, duke kaluar çdo vështirësi të mbizotërimit politik të myslimanëve, ka afruar elemente çrregullues, duke pasur në krye priftin jo legjitim Fan Noli, që vazhdon me grabitjen e kishës së Shën Gjergjit në Korçë dhe të vetmes kishë në Vlorë, duke i shndërruar në kisha të shqiptarëve nacionaliste dhe duke vendosur shqipen si gjuhë liturgjike.

Ata ankoheshin se protestat energjike të klerit e të popullit ortodoks si dhe demarshet e deputetëve ortodoksë qysh atëherë nuk ishin marrë në konsideratë. Së fundi, me urdhër të Kryetarit të Këshillit Shqiptar, Kosta Kotta, duke ekzekutuar vetë urdhrat e Ahmet Zogut, priftërinjtë Pater Tshamtshe (Camçe), Pater Agathangelos e Pater Euthimis Hoshtova kishin qenë rregullisht të rremë.

Me këto priftërinj të rinj, qeveria shqiptare kishte për qëllim, të kompletonte numrin e priftërinjve të nevojshëm për kushtetutën e një Sinodi të Shenjtë, për të proceduar menjëherë në organizimin e një grushti shteti me anë të cilit të krijojë Kishën Autoqefale Shqiptare.

Fakti që Kryetari i Këshillit, Kosta Kotta ishte ortodoks, nuk e zbehte karakterin tërësisht mysliman të qeverisë shqiptare, sepse nuk duhej harruar që Kotta ashtu si dhe Kryetari i Dhomës, Pandeli Evangjeli si dhe funksionarë të tjerë të lartë, i përkisnin asaj kategorie të krishterësh, që ishin zgjedhur me votat e myslimanëve, në sajë të sistemit elektoral në fuqi dhe në mungesë të lirisë së votës. Emërimi i të krishterëve si kryetarë këshilli e të Dhomës së Deputetëve, ishte favorizuar nga myslimanët, pasi këto emërimë ishin një avantazh për ata, sepse shërbenin si mantel për të mbuluar realitetin në sy të opinionit publik evropian dhe që presioni mbi të krishterët të ushtrohej në një mënyrë më metodike nga elementët e tyre.

Ata e akuzonin qeverinë shqiptare se, kishte dekretuar si priftërinj në krye të kishës shqiptare ortodokse, në mënyrë arbitrare, persona që i duheshin, me qëllim që të mbante nën kontrollin e saj organizimin fetar.

Shpjegimet e dhëna Lidhjes së Kombeve nga qeveria shqiptare për sa i përket përputhshmërisë së statutit të komuniteteve fetare me nenin 5 të Deklaratës, sipas autorëve të petitionit, nuk tregonin situatën reale. Ligji për Statutin legal të Komuniteteve fetare ishte votuar nga Dhoma shqiptare. Informacionet e dhëna Lidhjes së Kombeve për këtë qëllim nga qeveria shqiptare, nuk ishin të vërteta sepse, ndërkohë që thuhej se komunitetet fetare shqiptare ishin administrativisht të pavarura nga kishat e mëdha që e kanë selinë jashtë, kisha katolike shqiptare, në të kundërtën, ishte e varur gjithmonë administrativisht nga Vatikani. Për sa i përket

kishës ortodokse, ajo gjendej nën një regjim arbitrar, e detyruar me forcë nga qeveria shqiptare dhe nuk ishte e njohur nga popullsia ortodokse.

Qeveria shqiptare akuzohej se kishte shkelur nenin e 4 të Deklaratës, pasi, me vendim administrativ, u mohonte komuniteteve ortodokse shqiptare, mësimin e gjuhës greke, si gjuhë fetare edhe pse ishin shfaqur pakënaqësi të përsëritura të popullsisë së interesuar. Pastaj akuza bëheshin edhe se të krishterët, në praktikë, nuk ishin të pranueshëm në funksionet publike. Atyre u takonte të kishin 1/3 e funksioneve publike, por realisht kishin vetëm 1/8. Nenin 101 të Kushtetutës, i cili përcaktonte se “asnjë nuk mund të emërohet ministër në se nuk ishte i racës e gjakut shqiptar e që nuk flet gjuhën shqipe”, ata e cilësonin si një dispozitë që përjashtonte subjektet që nuk kishin origjinë shqiptare dhe prekte një pjesë të madhe të elementit të krishterë²⁰.

U ndalëm gjatë në paraqitjen e këtij peticioni për faktin se ai pasqyron konceptet nacionaliste greke dhe grekofile të cilat ishin kundërshtarë të vendosura të ndërtimit të institucioneve kombëtare në shtetin shqiptar dhe para së gjithash kundër autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare. Këto forca antikombëtare shqiptare të përpunuara edhe nga fqinjët greko-sllave të Shqipërisë ishin në radhë të parë një pengesë serioze kundër ndërtimit të një shteti kombëtar shqiptar unik dhe funksionues. Deklarata e vitit 1921 dhe parashikimet e saj për minoritetet u interpretuan dhe u përdorën pikërisht në një mënyrë që të pengonte procesin e formimit të institucioneve kombëtare dhe procesin e konsolidimit të ndërgjegjes kombëtare dhe të kombit-shtet. Për temën tonë në shqyrtim është e rëndësishme të pohojmë se megjithëse këto pretendime nuk kishin të bënin fare me çështjet e minoriteteve të cilat ishin subjekt i diskutimit dhe mbrojtjes nga LK dhe traktatet e saj ato u diskutuan me seriozitet prej saj dhe ndaj shtetit shqiptar u ushtrua një presion i ndjeshëm ndërkombëtar për ta dekurajuar në procesin e kombëtarizimit të institucioneve fetare, arsimore dhe politike të tij.

Qeveria shqiptare informoi Sekretarin e Përgjithshëm me 6 prill 1929 se ajo nuk e konsideronte të mundshme që të bënte ndonjë vëzhgim dhe koment për këtë peticion ndërsa Sekretari i përgjithshëm njoftoi anëtarët e Këshillit për peticionin dhe për letrën e qeverisë shqiptare.²¹

²⁰ *Po aty.*

²¹ FO 286/1044, Notë e qeverisë shqiptare nënshkruar nga M. Tutulani për Sekretarin e Përgjithshëm të LK, 6 prill 1929.

Në vijim të fushatës dhe të presionit të fuqishëm që po ushtrohej kundër qeverisë shqiptare për ta dekurajuar atë në rrugën e forcimit të shtetit kombëtar u angazhua edhe një pjesë e klerit ortodoks në Shqipëri. Me 9 prill 1929 peshkopi i Korçës Ierotheos i dërgoi një telegram Sekretarit të Përgjithshëm të LK ku ankohej për masat represive që kishin ndërmarrë autoritetet shqiptare kundër popullsisë ortodokse. Sekretari i Përgjithshëm vendosi që, për arsye të natyrës së fakteve që paraqiteshin në këtë telegram, të ndiqte një procedurë urgjente për t'ia paraqitur këtë çështje Këshillit të LK.²² Qeveria shqiptare u detyrua edhe një herë të jepte shpjegime për pa vërtetësinë e këtyre akuzave.

Për ta amplifikuar procesin e presionit dhe sulmit që po u bëheshin politikave kombëtarizuese të qeverisë shqiptare u mobilizua edhe shtypi grek. Përfaqësuesi britanik në Greqi njoftonte në mënyrë të detajuar Forin Ofisin se në shtypin grek kohët e fundit ishin botuar raporte të cilat zmadhonin dhunën e ushtruar nga myslimanët ndaj komunitetit ortodoks në Delvinë gjatë celebrimit të një liturgjie në kishën lokale. Këto raporte, rëndësia e të cilave ishte minimizuar në një telegram të Prefektit të Korfuzit, kishin shkaktuar një zemërim jo të vogël në vend dhe duket se mund të dëmtonin marrëdhëniet shqiptaro-greke. Gazeta "Hestia" shkruante se incidenti në Delvinë tregonte se sa larg kishte shkuar Shqipëria në mos zbatimin e detyrës themelore për respektimin e fesë së minoritetit e cila ishte e imponuar nga traktati për mbrojtjen e minoriteteve. Kur shteti zyrtar shqiptar sillet në mënyrë kaq të padrejtë ndaj kishës ortodokse dhe krijon një krijesë mizerabël si një kishë autonome me prelatë të padenjë për të veshur rrobën e priftit, është e natyrshme që myslimanët injorantë do të vijonin me të gjitha llojet e sulmeve dhe të dhunës. Kjo ishte karakteristikë e një vendi që injoronte edhe detyrimet më elementare të qytetërimit. Sipas gazetës, qeveria shqiptare kishte bërë një gabim i cili kishte helmuar në mënyrë të rrezikshme marrëdhëniet midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe, natyrshëm, ishte i destinuar që të krijonte gjithashtu edhe vështirësi të brendshme. Do të ishte mirë që Shqipëria të pranonte gabimin e saj dhe ta ndreqte atë para se të ishte shumë vonë. Me këtë kuptohej heqja dorë nga procesi i autoqefalisë së kishës ortodokse shqiptare.

²² FO 248/1044, Notë e Sekretarit të Përgjithshëm të LK drejtuar anëtarëve të Këshillit të LK, Gjenevë, 13 prill 1929.

Gazeta “Ethnos” shtronte pyetjen se për sa kohë qeveria greke do të toleronte këtë situatë të krijuar nga Shqipëria. Ndërsa “Patris” shkruante me ironi se civilizimi po penetronte gjithnjë e më shumë në Shqipëri dhe grekët ishin të parët që po provonin efektet e këtij progresi të mrekullueshëm. Ata po vriteshin dhe nuk po lejoheshin të ushtronin besimin e tyre. Madhëria e tij Zogu I, është krenar për civilizimin dhe evropianizimin e subjekteve të tij. “Elefteron Vima” shkruante se ishte koha më kritike që qeveria shqiptare dhe organet e saj të mbanin një qëndrim më tolerant dhe të respektonin ndjenjat fetare të ortodoksëve, pasi ishte krijuar përshtypja se po ushtrohej një shtypje sistematike kundër atyre që donin të ruanin besimin tradicional të tyre. Ky qëndrim nuk do të kontribuonte për harmoninë midis racave në Shqipëri dhe do të dëmtonte qeverinë e mbretërisë së re.²³ Gjithashtu gazeta e lartpërmendur përcillte edhe një protestë të “ortodoksëve shqiptarë” që banonin në Athinë dhe në Pire kundër krijimit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe kundër mbështetjes që i kishte dhënë qeveria shqiptare asaj.

Ministri britanik në Shqipëri, Hodgson e diskutoi këtë çështje me ministrin grek, Melas. Ai njoftonte Forin Ofisin se Melas dukej shumë i zemëruar nga akuza që kishte bërë Ministri i Jashtëm shqiptar, Rauf Fico, se njëri nga zyrtarët konsullorë grekë në Shqipëri ishte përfshirë në agjitacionin kundër kishës ortodokse shqiptare. Lidhur me versionin e ngjarjes së Delvinës të dhënë në shtypin grek se gjoja një bandë me të rinj myslimanë kishin hyrë në kishë, Melas tha se ky version ishte i rremë dhe botimi i historive të tilla nuk i shërbente çështjes greke. Ai tha se ngjarja ishte shkaktuar nga një mësues lokal i cili, i shoqëruar nga disa të rinj, kishte shkuar në kishë dhe kishin filluar të këndonin ritet fetare në gjuhën shqipe. Delvina, shtoi Melas, ishte një qendër grekofone dhe disa gra kishin protestuar. Pas një rrëmuje të shkurtër disa burra ishin arrestuar dhe po mbaheshin ende në burg në Tiranë, me gjithë premtimet e dhëna nga Ministri i Punëve të Jashtme se çështja kundër tyre do të mbyllej.

Për të bllokuar procesin e autoqefalisë grekët vendosën në qendër të goditjes Visarion Xhuvanin. Melas kishte takuar Mbretin Zog disa ditë më parë. Ky takim zhvillohej për herë të parë pas disa muajve. Mbreti i kishte thënë ministrit Grek se ai ishte shumë i gatshëm që të kontribuonte për përmirësimin e marrëdhënieve greko-shqiptare. Më tej, Melas kishte

²³ FO 286/1044, Percy Loraine nga Athina për Austen Chamberlain, 3 prill 1929.

kërkuar heqjen e peshkopit Visarion nga Sinodi. Ai përmendte si argument një bisedë të bërë më parë me Rauf Ficon dhe të tjerë zyrtarë shqiptarë të cilët kishin lënë të kuptohej se një gjë e tillë, nëse do të ishte e dëshirueshme, nuk ishte e pamundur që të diskutohej. Me gjithë këtë peshkopi ishte zgjedhur sërish kohët e fundit në postin e tij dhe kështu, heqja e tij ishte e vështirë që të bëhej në të ardhmen e afërt. Diplomati grek e cilësoi Visarionin një pengesë kryesore për njohjen e Sinodit të KOASH nga kishat ortodokse si motra, për të cilën ai besonte se do të ndodhte.²⁴ Në fakt grekët donin të eliminonin Visarionin i cili kishte qenë njëri ndër elementët kryesorë që kishte drejtuar procesin e autoqefalisë. Në këtë mënyrë ata synonin të dekurajonin klerikët e tjerë patriotë, të fusnin një kundërshti midis tyre dhe qeverisë shqiptare dhe në këtë mënyrë të dekurajonin dhe frenonin procesin e mëtejshëm të afirmimit të autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare.

Ndërkohë, Sekretariati i LK, duke vijuar t'i merrte seriozisht të gjitha ankesat e bëra nga individë dhe grupe emigrantësh politikë apo persona që ishin të shtyrë nga qeveria greke kundër krijimit të KOASH, kishte krijuar një Komitet nën kryesimin e delegatit italian dhe të përbërë nga delegatët britanikë dhe finlandezë në LK. Ata morën në shqyrtim peticionet e ndryshme lidhur me gjendjen e popullsisë së krishterë në Shqipëri. Sekretari i Përgjithshëm e konsideroi situatën si serioze. Përfaqësuesi britanik i shkruante Forin Ofisit se askush nuk mund ta mohonte se qeveria shqiptare kishte të drejtë të krijonte kishën autoqefale, por vërejtja ishte se kishte akuza që personat të cilët kishin refuzuar të njihnin kishën e re autoqefale, ishin burgosur ose ishin keqtrajtuar. Komiteti kishte rënë dakord se vërejtjet që ishin bërë për këtë çështje kishin qenë serioze dhe ishte i mendimit se qeverisë shqiptare i duheshin kërkuar garanci zyrtare që askush të mos burgosej për arsye se nuk kishte njohur kishën e re. Sekretari i Përgjithshëm i raportoi Komitetit se një përfaqësues grek i kishte thënë atij që kohët e fundit qeveria shqiptare kishte deklaruar se askush nuk ishte burgosur për këtë arsye. Ai ishte shprehur se, ishte e vërtetë që momentalisht qeveria shqiptare sapo kishte liruar të gjithë të burgosurit, por vetëm pak dit më vonë, pas deklaratës së saj ajo, sipas informacionit që kishte dhënë në mirëbesim përfaqësuesi grek, kishte burgosur përsëri personat që kishte

²⁴ FO 286/1044, R. M. Hdgson nga Durrësi për Arthur Henderson, 18 qershor 1929.

pas liruar. Madje, kishte bërë edhe arrestime të tjera. Komiteti kishte rënë dakord që çështjet e parashtruara në peticionin e dërguar nga Foto Dusi dhe Koço Tasi duheshin ndjekur më tej. Kështu ata kishin vendosur që t'i kërkonin qeverisë shqiptare të deklaronte në se akuzat lidhur me burgosjen e personave të përmendur ishin të vërteta dhe që ajo të jepte garanci formale se ata nuk do të burgoseshin nëse ata nuk pranonin përsëri të njihnin kishën autoqefale.²⁵

Qeveria shqiptare ishte e shqetësuar se në këto momente po vërehej një bashkëpunim midis kishës greke dhe asaj serbe për të penguar procesin e autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare dhe për të ndërhyrë secila për llogari të vet në çështjet e saj. Por diplomati tjetër britanik në Shqipëri, Philip Usher nuk besonte në informacionin që i kishte dhënë Hodgsonit, Mbreti Zog lidhur me mirëkuptimin që ekzistonte midis Patriarkatit serb dhe Fanarit për çështjen e kishës shqiptare. Ai pohonte se metropolitani Krisanthos, gjatë bisedave që kishte pasur me të, i ishte shmangur përmendjes së çështjes së vonesave të Patriarkanës në njohjen e kishës shqiptare si autoqefale. Usher, nga ana tjetër, mendonte se Krisanthosi ishte treguar i sinqertë lidhur me përshkrimin e takimeve që ai kishte pasur gjatë vizitës së tij në Beograd. Fillimisht ai kishte takuar Patriarkun Dimitri i cili kishte thënë se nuk dinte asgjë rreth aktivitetit të peshkopit Viktor në çështjen e kishës shqiptare dhe i kishte premtuar Krisanthosit se do të kërkonte shpjegime. Pastaj Krisanthosi kishte takuar Seftiçin i cili ishte ministër i oborrit. Ai nuk kishte fshehur kënaqësinë për gjithçka kishte ndodhur dhe kishte pranuar se kjo ishte vetëm një përgjigje për injorimin e interesave serbe nga Fanari në marrëveshjen e Trebizandit të vitit 1926. Rrjedhimisht Krisanthosi ishte këshilluar nga Montgomery i cili kishte zëvendësuar Kennard, që ai të takonte Mbretin Aleksandër. Mitropoliti theksoi se Mbreti ishte treguar shumë simpatik dhe i kishte dhënë siguri zyrtare se nuk do të bëhej asgjë që do të provokonte një grindje me Fanarin. Usher shkruante se ndërgjegjja ortodokse vepronte në rrugë të çuditshme dhe, kështu, shpesh ishte e vështirë të llogariteshin veprimet e saj. Por ai shprehte bindjen se kur dy peshkopët grekë dhe autoritetet serbe do të shtrinin veprimtarinë e tyre në Shqipëri, veprimi i tyre do të krijonte një çarje të hapur me Patriarkanën Ekumenike. Atëherë ata do të tërhiqeshin

²⁵ Po aty, Shënime të A. Cadogan nga mbledhja e Komitetit të Minoriteteve, 10 qershor 1929.

mbrapa nga ajo që për ta do të ishte një turpërim publik dhe, kështu, shpjegohej sjellja e tyre. Krisanthosi kishte deklaruar se ishte vështirë që veprimi i serbëve të shpjegohej me zemërimin e tyre për mos vlerësimin e pozitës së Viktorit në marrëveshjen e vitit 1926. Ai pohoi se në atë kohë shqiptarët, duke mos dashur që të vepronin forcërisht për ta dëbuar këtë prelat, nxitën Patriarkatin Ekumenik të vepronte kundër tij si ndërhyrës në juridiksionin e tij. Duke mos dashur të përfshihej në një çështje kaq delikate, Krisanthosi u kishte kthyer një përgjigje jo të hapur, për të cilën ai kishte marrë më pak se një falënderim të vërtetë nga serbët. Usher shkruante se, ishte e vështirë të parashikohej se si mund të rregullohej situata e rënduar nga budallallëku i diplomatëve grekë dhe serbë dhe nga dobësia e Patriarkatit Serb i cili kishte lejuar që t'u nënshtrohej konsideratave politike, duke konsakruar një prelat të cilin ai nuk e pranonte. Sipas Usherit nevoja e parë ishte që përfaqësitë në Beograd dhe në Athinë duhej të hiqnin dorë nga përdorimi i kësaj çështje si një fushë për intrigat e tyre.²⁶

Në korrik të vitit 1929 qeveria shqiptare ju përgjigj një letre të përfaqësuesit britanik në Këshillin e LK për çështjet që ngrinin petitionet e M. Dusit e K. Tasit dhe të Ierotheut, duke i dhënë shpjegime shtesë. Forin Ofisi mori një informacion të detajuar nga ministri britanik në Tiranë, Hodgson i cili theksonte se personat e arrestuar në Delvinë ishin liruar disa ditë më parë dhe ishin kthyer në shtëpitë e tyre. Ata ishin mbajtur në burg për rreth 3 muaj, për arsye se ministrat e kabinetit ishin grindur midis tyre për këtë çështje. Ministri i drejtësisë, Hiqmet Delvina, të cilin Hodgson e konsideronte si anëtarin më të paaftë të një kabinetit të papërshtatshëm, ishte ai që e kishte shkaktuar këtë turbullirë. Ai kishte kërkuar që të zbatohet ligji dhe Mbreti kishte marrë anën e tij. Ndërsa Rauf Fico kishte shprehur, në një mënyrë të vakët, një opinion tjetër. Ai kishte kërkuar që çështja të mbyllet dhe kështu të shmangej botimi në shtyp i lajmeve për të, gjë që do të vështirësonte më tej marrëdhëniet shqiptaro-greke. Por ai ishte një anëtar i ri i kabinetit dhe hezitonte që të vihej në opozitë me gjithë kolegët dhe me Mbretin. Më tej ndërhyri Ministri italian Sola tek Mbreti dhe i shpjegoi atij dëmin që do t'i shkaktohej Shqipërisë në qoftë se këta njerëz do të dilnin para gjyqit politik.

²⁶ FO 286/1044, Komente të Philip Usher, 22 qershor 1929.

Hodgson theksonte se kjo ishte në vetvete një çështje bajate e cila ishte krijuar për arsye të luftës midis grupeve politike brenda udhëheqjes shqiptare. Ai gjykonte se nga të dy versionet që i ishin paraqitur Lidhjes së Kombeve nga qeveritë shqiptare dhe greke, versioni shqiptar përmbante më shumë pasaktësi se sa ai grek. Në të vërtetë situata dhe lëkundjet kishin të bënin me dilemat e qeverisë shqiptare për mënyrën e reagimit ndaj ndërhyrjes greke për të penguar procesin e autoqefalisë së KOSH.

Sipas Hoddgsonit, rëndësia e këtij incidenti nuk qëndronte tek vetë ngjarjet e Delvinës por në bekgraundin që qëndronte pas tyre. Sipas qeverisë shqiptare kundërshtimi i kishës autoqefale nuk kishte origjinë vendase. Ky kundërshtim ishte vetëm një manifestim i një lëvizje të vjetër e cila ishte sa e njohur aq edhe e padëshirueshme. Karapanos i cili kishte qenë Ministër i Jashtëm i Greqisë, në kohën kur fushata kundër Kishës Autoqefale Shqiptare kishte filluar, kishte qenë dikur ministër i Jashtëm i qeverisë provizore të Epirit të Veriut. Ai i konsideronte gjysmë bindëse shpjegimet që i kishte dhënë Melas se angazhimi në ngjarjet e vitit 1914 kishte qenë një gabim i Karapanosit në ato ditë të ngatërruara prej të cilit ai kishte hequr dorë. Shqiptarët me mendim nationalist si Rauf Fico, ata shqiptarë që ankoheshin për ndërhyrjen e jashtme në çështjen e kishës autoqefale, ishin infektuar me herezinë epirote; Një kongregacion që kërkonte mbajtjen e gjuhës greke në liturgjinë kishtarë konsiderohej se vinte nga agjentët grekë.

Hodgsoni mendonte se rrethanat ishin të tilla që e bënin të vështirë për LK të ndërhynte në mënyrë efektive. Informacioni që kishte marrë LK ishte detyrimisht i paragjykuar, pasi ai vinte nga burimet greke. Asgjë më tepër nuk do ti zemëronte shqiptarët se sa të aprovoheshin anatemit e Ierotheos, të cilat shqiptarët do t'i hidhnin poshtë, duke theksuar se njerëzit e arrestuar në Delvinë ishin përfshirë në intriga të paligjshme. Ndërhyrja që kishte sponsorizim grek kishte pak shans që të përmirësonte situatën e krijuar nga ngjarjet që kishin ndodhur. Hodgson njoftonte Forin Ofisin se Melas kishte filluar përpjekjet me shqiptarët për të fituar besimin e tyre, megjithëse Rauf Fico ende mendonte se Legata greke po zhvillonte një propagandë fanariote midis shqiptarëve. Tashmë ishte në dorën e Melasit për të organizuar një takim midis Peshkopit Krisanthos dhe një përfaqësuesi të Sinodit shqiptar. Qeveria shqiptare i kishte dhënë besimin e saj këtij projekti. Por këtu përsëri prezenca e ish peshkopit të Korçës në Follorinë, afër kufirit shqiptar, nuk ishte një faktor që

ndihmonte, ashtu siç e kishte pranuar dhe vetë Melas. Hodgsoni pohonte se qeveria greke, në qoftë se donte me të vërtetë që këto bisedime të shkonin mirë, duhej ta transferonte këtë klerik të papërgjegjshëm në një zonë tjetër që ishte më larg skenës ku kishte qenë peshkopata e tij.²⁷

Kështu deri në këtë periudhë debati shqiptaro-grek ishte i mbushur plot me çështje të rëndësishme të cilat mund të përmbliidhen në tre grupe kryesore por që ishin shumë të lidhura dhe gati të shkrija organikisht midis tyre. Së pari ishte çështja e formësimit të institucioneve kombëtare në Shqipëri të cilat kundërshtoheshin nga qeveria, kisha dhe shtypi grek për arsye se binin ndesh me interesat dhe konceptet e tyre për natyrën e ortodoksëve shqiptarë dhe të institucioneve që kishin të bënë me ta. Së dyti ishte çështja e pakicës shqiptare në Greqi e cila i ishte nënshtruar më parë një fushate të gjerë dhe intensive spastrimi etnik, pasojat e së cilës vijonin të ndjeheshin fort dhe qeveria shqiptare po përpiqej që t'i lehtësonte ato, duke hasur, siç e përmendëm më lart, në kundërshtimin e qeverisë greke por edhe në indiferencën e LK dhe të Fuqive të Mëdha evropiane të kohës. Së treti ishte çështja e minoritetit grekofon në Shqipëri i cili, ndonëse gëzonte një trajtim korrekt dhe të pakrahasueshëm me trajtimin që i bëhej pakicës shqiptare në Greqi, po përpiqej të avanconte më tej pozitën e tij, duke u mbështetur kryesisht në presionin që bënte qeveria greke. Kjo problematikë po i mbante marrëdhëniet shqiptaro-greke në një gjendje stresi dhe sigurisht që pengonte krijimin e një klime mirëbesimi e bashkëpunimi midis të dy palëve.

S u m m a r y

THE ISSUE OF THE ALBANIAN AND GREEK MINORITIES WITHIN THE INTERNATIONAL ORGANIZATIONS DURING 1925 – 1929

The Great Powers of that time and the international organizations that dealt with the minorities treated the issues of the foreign minorities in Albania and the Albanian minorities in Greece in a disproportional manner.

A typical example of the above is the way the Albanian minority in Chameria was treated as compared to the Greek-speaking minority in South Albania. This article

²⁷ FO 286/1044, R. M. Hodgson nga Durrësi për Arthur Henderson, 6 gusht 1929.

presents new data on this subject. The principal study uses a comparative methodology, based on all the indications concerning the social and economic situation, as well as the political rights of the minorities. It reflects the efforts of the Albanian government for the protection of the Cham population and its interrelationship with the international organizations. The Greek – Albanian debate on the protection and treatment of the minorities, as well as the dissymmetrical policies followed by the two countries towards their respective minorities are treated in a detailed way. The Yugoslavian – Albanian relations on the issues of minorities and religion are dealt with in the same narrow manner.

Inside the article one can find an elaborate reflection of the position kept by the British government and legations towards the issue of Greek and Albanian minorities and the rapports between the two countries.

A documented presentation covers the attitude of the Greek and Albanian press towards the issues of the minorities.

